



FAKULTETI JURIDIK

RAPORTI SEMESTRAL I CILËSISË
SEMESTRI VEROR

2024-2025

Prishtinë, Kosovë

PERMBAJTJA

KAPITULLI I: ANALIZË E REZULTATEVE TË PYETËSORIT TË VLERËSIMIT TË STAFIT- DEGA PRISHTINË	5
VITI I PARË: SEMESTRI II	5
VITI I DYTË: SEMESTRI IV	8
VITI I TRETË: SEMESTRI IV	11
VITI IV: SEMESTRI VIII	14
4.1. Specializimi Civil (Prishtinë).....	14
4.2. Specializimi Penal.....	16
KAPITULLI II: ANALIZË E REZULTATEVE TË PYETËSORIT TË VLERËSIMIT TË STAFIT-DEGA PRIZREN	19
VITI 1: SEMESTRI II (Dega Prizren).....	19
VITI I DYTË: SEMESTRI IV (Dega Prizren)	22
VITI I TRETË: SEMESTRI VI (Dega Prizren)	24
VIII-SPECIALIZIMI PENAL (Viti i katërt, dega Prizren)	27
KAPITULLI 3: PROGRAMET MASTER	30
3.1. E Drejta Civile dhe e Pronës (LLM)-Semestri II (Prishtinë).....	30
3.2. E Drejta Penale (LLM)-Semestri II (Prishtinë)	33
KONKLuzionET	36

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Raporti i cilësisë për semestrin veror 2024-2025 synon të ofrojë një analizë të hollësishme të performancës së programeve të studimit në Fakultetin Juridik të Kolegjit UBT gjatë kësaj periudhe akademike. Bazuar në rezultatet e një pyetësoi të ndërmarrë nga Zyrja e Cilësisë, i cili u është shpërndarë studentëve të dy programeve bachelor LLB në Juridik në Prizren dhe Prishtinë, si dhe dy programeve master: LLM në të drejtën civile dhe të pronës, dhe LLM në të drejtën penale, ky raport ofron një vlerësim të detajuar të performancës së këtyre programeve.

Rezultatet e vlerësimit tregojnë se në përgjithësi, shkalla e kënaqshmërisë së studentëve me elementet e mësimdhënies dhe pedagogjisë është në përputhje me standardet e përcaktuara në Planin Strategjik të Fakultetit, në shumicën e programeve duke arritur ose tejkaluar pragun e 4.0 si indikatorin e performancës së cilësisë.

Për të përmirësuar edhe më tej cilësinë e mësimdhënies, raporti rekomandon disa hapa të rëndësishëm:

1. Përmirësimi i interaktivitetit në ligjëratë dhe përdorimi i metodave të përshtatshme të vlerësimit në të gjitha nivelet e studimit.
2. Sigurimi që obligimet e lëndës dhe materialet për studim janë të qarta dhe të qasshme për studentët.
3. Sensibilizimi dhe pjesëmarrja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe promovimi i rëndësisë së këtij procesi në rritjen e cilësisë së përgjithshme të arsimit në fakultet.

Këto rekomandime përbëjnë një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies në Fakultetin Juridik në UBT, duke siguruar një mjedis më efektiv dhe inovativ për të gjithë studentët.

HYRJE

Raporti i cilësisë për semestrin veror 2024-2025, i Fakultetit Juridik synon të ofrojë një analizë të hollësishme të performancës së programeve të studimit gjatë kësaj periudhe akademike. Ky raport bazohet në rezultatet e një pyetësoi të ndërmarrë nga Zyrja e Cilësisë, i cili i është shpërndarë studentëve të dy programeve bachelor: LLB në Juridik në Prizren dhe Prishtinë, si dhe dy programeve master: LLM në të drejtën civile dhe të pronës, dhe LLM në të drejtën penale, ky raport ofron një vlerësim të detajuar të performancës së këtyre programeve.

Ky raport analizon rezultatet e këtij vlerësimi dhe ofron një pasqyrë të qartë të cilësisë së mësimdhënies dhe pedagogjisë, duke adresuar dhe vlerësuar çdo element në mënyrë të detajuar. Në bazë të Nën-Qëllimit 4.2 të Planit Strategjik 5-vjeçar të Fakultetit Juridik, i cili mund të gjendet online në <https://www.ubt-uni.net/wp-content/uploads/2021/10/Action-Plan-for-Implementation-of-5-year-strategy-Law-Faculty.pdf>, pragu i kënaqshmërisë së studentëve me elementet e mësimdhënies dhe pedagogjisë duhet të jetë mbi 4.0 ose 80%. Për të arritur këtë qëllim, është bërë një analizë e mesatareve të kënaqshmërisë për secilin semestër dhe për secilin profesor. Raporti analizon kënaqshmërinë e studentëve për çdo element të vlerësuar në pyetësor, duke përfshirë respektimin e orarit, qartësinë e shpjegimit dhe metodën e ligjeratave, nxitjen e interaktivitetit, bashkëpunimin me studentët, sjelljen ndaj studentëve, qartësinë e obligimeve të lëndës, disponueshmërinë e materialeve për studim, si dhe metodat e vlerësimit të përdorura nga profesorët. Nëse kënaqshmëria e studentëve për secilin element është nën pragun e 4.0, raporti ofron rekomandime për përmirësim. Këto rekomandime janë bazuar në synimet e përcaktuara nga secili profesor në kuadër të Planeve Zhvillimore Individuale në pjesën e aspektit pedagogjik.

Me bazë në këto analiza dhe rekomandime, Fakulteti synon të përmirësojë përvojën mesimore për studentët e saj dhe të sigurojë një qëndrueshmëri të lartë në cilësinë e ofruar në fushën e drejtësisë.

KAPITULLI I: ANALIZË E REZULTATEVE TË PYETËSORIT TË VLERËSIMIT TË STAFIT- DEGA PRISHTINË

VITI I PARË: SEMESTRI II

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë gjithsej 21 studentë të vitit të parë të Fakultetit Juridik, të cilët kanë vlerësuar performancën e 6 anëtarëve të stafit akademik përmes një sërë kriteresh pedagogjike. Vlerësimet janë dhënë në shkallën nga 1 (shumë dobët) deri në 5 (shkëlqyeshëm) dhe kanë përfshirë aspekte kyçe të procesit mësimor. Më poshtë paraqiten vërejtjet dhe analiza kryesore:

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja: **4.61**

Studentët kanë vlerësuar pozitivisht qartësinë e syllabusit dhe detyrimeve që u janë prezantuar në fillim të semestrit. Kjo tregon për një përgatitje të mirë administrative dhe komunikim efektiv nga ana e stafit.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	4.0
JUR-STAFF-035	4.52
JUR-STAFF-026	4.57
JUR-STAFF-033	4.71
JUR-STAFF-008	4.95
JUR-STAFF-020	4.86

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja: **4.89**

Ky është kriteri më i vlerësuar, çka tregon për përkushtim dhe disiplinë të lartë të stafit në përmbushjen e orarit dhe përgjegjësi të tyre mësimore. Studentët e kanë vlerësuar shumë qëndrueshmërinë dhe mungesën e vonesave.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	4.76
JUR-STAFF-035	4.76
JUR-STAFF-026	4.71
JUR-STAFF-033	4.76
JUR-STAFF-008	4.95

JUR-STAFF-020	4.9
---------------	-----

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja: **4.62**

Rezultatet tregojnë se shumica e stafit kanë arritur të transmetojnë përmbajtjen e lëndëve në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Megjithatë, disa komente sugjerojnë se një pjesë e vogël e stafit ka nevojë të përmirësojë mënyrën e komunikimit me studentët.

Tabela 3: Qartësia në ligjërimit

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	3.29
JUR-STAFF-035	4.29
JUR-STAFF-026	4.57
JUR-STAFF-033	4.76
JUR-STAFF-008	4.81
JUR-STAFF-020	4.76

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja: **4.64**

Studentët kanë raportuar nivel të lartë bashkëpunimi dhe përfshirjeje në orët mësimore. Kjo është një pikë pozitive, sidomos për studentët e vitit të parë, të cilët kanë nevojë për më shumë mbështetje dhe inkurajim për t'u angazhuar.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	3.76
JUR-STAFF-035	4.48
JUR-STAFF-026	4.62
JUR-STAFF-033	4.71
JUR-STAFF-008	4.81
JUR-STAFF-020	5.0

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja: **4.61**

Materialet e ofruara janë vlerësuar si të përshtatshme dhe të qasshme, veçanërisht përmes platformës Moodle. Kjo tregon për një angazhim të mirë në aspektin teknik dhe logjistik.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	3.95
JUR-STAFF-035	4.52
JUR-STAFF-026	4.62
JUR-STAFF-033	4.62
JUR-STAFF-008	4.76
JUR-STAFF-020	4.81

6. Metodatat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja: 4.55

Kjo është kategoria me mesataren më të ulët (por ende të lartë). Studentët kanë dhënë sinjale se ndonjëse përdoren metoda të ndryshme vlerësimi, mund të ketë vend për më shumë qartësi në mënyrën e testimit gjatë semestrit.

Tabela 6: Metodatat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	3.76
JUR-STAFF-035	4.48
JUR-STAFF-026	4.57
JUR-STAFF-033	4.71
JUR-STAFF-008	4.76
JUR-STAFF-020	4.76

Komente cilësore nga studentët:

- Studentët kanë vlerësuar motivimin, përkushtimin dhe korrektësinë e shumicës së profesorëve.
- Janë paraqitur disa komente kritike individuale për qartësinë e komunikimit të ndonjë profesori.
- Është kërkuar më shumë atraktivitet dhe aktivitete praktike në disa lëndë.
- Është përmendur edhe një çështje organizative për reduktimin e kohës së ushtrimeve për të shmangur mbingarkesën.

Përfundim

Rezultatet në përgjithësi janë shumë pozitive, veçanërisht për një grup studentësh të vitit të parë, që janë ende në procesin e përshtatjes me arsimin universitar. Performanca e stafit vlerësohet si profesionale dhe efektive, me disa mundësi për përmirësim në drejtim të komunikimit dhe metodave të vlerësimit.

VITI I DYTË: SEMESTRI IV

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë gjithsej 5 studentë të vitit të dytë të Fakultetit Juridik, të cilët kanë vlerësuar performancën e 7 anëtarëve të stafit akademik përmes një sërë kriteresh pedagogjike. Vlerësimet janë dhënë në shkallën nga 1 (shumë dobët) deri në 5 (shkëlqyeshëm) dhe kanë përfshirë aspekte kyçe të procesit mësimor. Më poshtë paraqiten vërejtjet dhe analiza kryesore:

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: **4.97**

Studentët kanë vlerësuar maksimalisht qartësinë e syllabusit dhe të detyrimeve që janë prezantuar në fillim të semestrit. Kjo reflekton një standard të lartë të transparencës dhe organizimit të stafit.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-006	5.0
JUR-STAFF-018	5.0
JUR-STAFF-019	5.0
JUR-STAFF-029	5.0
JUR-STAFF-016	4.8
JUR-STAFF-002	5.0
JUR-STAFF-031	5.0

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja e përgjithshme: **4.94**

Përveç një rasti të izoluar, vlerësimet janë të përsosura. Kjo tregon për një nivel të lartë përkushtimi të stafit në respektimin e orarit dhe vazhdimësinë e ligjëratave.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-006	4.4
JUR-STAFF-018	5.0
JUR-STAFF-019	5.0
JUR-STAFF-029	5.0
JUR-STAFF-016	5.0
JUR-STAFF-002	5.0
JUR-STAFF-031	5.0

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Të gjithë anëtarët e stafit janë vlerësuar me notën maksimale, çka dëshmon për një aftësi të shkëlqyer në transmetimin e njohurive dhe qartësinë në komunikim akademik.

Tabela 3: Qartësia në ligjërime

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Studentët kanë raportuar një nivel të lartë të bashkëpunimit dhe nxitjes së pjesëmarrjes aktive. Kjo reflekton aftësinë e stafit për të krijuar një ambient mësimor interaktiv dhe përfshirës.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Të gjitha vlerësimet ishin të plota, duke konfirmuar se materialet e lëndës ishin të mirëorganizuar dhe të qasshme për studentët.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

6. Metodatat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Kjo kategori gjithashtu është vlerësuar maksimalisht, duke dëshmuar për korrektësi dhe përkushtim në procesin e vlerësimit të studentëve.

Tabela 6: Metodatat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

Komente cilësore nga studentët:

- Studentët theksojnë vlersojnë lartë profesionalizmin e të gjithë profesorëve.
- U përmend që UBT nuk ka nevojë për përmirësime, por për njohje nga studentët që do bëhen liderë.
- Ka një koment i cili kërkon që orari të jetë më i shpërndarë gjatë javës, për të shmangur ngarkesën.

Përfundim

Rezultatet në përgjithësi janë shumë pozitive, duke reflektuar një performancë të shkëlqyer të stafit akademik në të gjitha aspektet. Studentët e semestrit të katërt kanë treguar një nivel të lartë kënaqësie për qartësinë, angazhimin dhe përkrahjen e stafit. Të vetmet sugjerime lidhen me aspektin organizativ të shpërndarjes së orëve. Stafi i përfshirë në këtë semestër ka dhënë shembullin e një praktike të suksesshme të mësimdhënies.

VITI I TRETË: SEMESTRI IV

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë gjithsej 4 studentë të vitit të tretë të Fakultetit Juridik, të cilët kanë vlerësuar performancën e 5 anëtarëve të stafit akademik përmes një sërë kriteresh pedagogjike. Vlerësimet janë dhënë në shkallën nga 1 (shumë dobët) deri në 5 (shkëlqyeshëm) dhe kanë përfshirë aspekte kyçe të procesit mësimor. Më poshtë paraqiten vërejtjet dhe analiza kryesore:

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: **4.16**

Rezultatet tregojnë një nivel të kënaqshëm të qartësisë së obligimeve të studentëve, megjithatë ka dallime të dukshme mes stafit. Disa mësimdhënës janë vlerësuar maksimalisht, ndërsa disa të tjerë kanë marrë nota dukshëm më të ulëta, që ndikojnë në mesataren totale.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-014	3.5
JUR-STAFF-002	2.75
JUR-STAFF-013	4.5
JUR-STAFF-041	4.5
JUR-STAFF-027	4.75

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja e përgjithshme: **4.75**

Stafi në përgjithësi është vlerësuar si shumë i rregullt në ligjërata, me vetëm një rast të izoluar që ka ndikuar pak në uljen e mesatares për një staf.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-014	5.0
JUR-STAFF-002	3.75
JUR-STAFF-013	4.75
JUR-STAFF-041	5.0
JUR-STAFF-027	4.75

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: **4.25**

Ka një përzierje vlerësimesh për këtë kriter, me disa stafë të vlerësuar shumë lartë, ndërsa një apo dy kanë marrë vlerësime dukshëm më të ulëta që e ulin mesataren në këtë kategori.

Tabela 3: Qartësia në ligjërime

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-014	3.25
JUR-STAFF-002	3.0
JUR-STAFF-013	4.75
JUR-STAFF-041	4.5
JUR-STAFF-027	4.75

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: **4.0**

Ky është kriteri me vlerësimet më të ulëta krahasuar me të tjerët. Duket se disa profesorë nuk kanë arritur të angazhojnë studentët në mënyrë interaktive në të njëjtën shkallë me të tjerët.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-014	2.75
JUR-STAFF-002	3.0
JUR-STAFF-013	4.75
JUR-STAFF-041	4.5
JUR-STAFF-027	3.75

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: 4.95

Studentët kanë vlerësuar lartë përgatitjen dhe qasjen në materiale për të gjitha lëndët. Ky është një nga kriteret më pozitive në këtë semestër.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-014	4.75
JUR-STAFF-002	5.0
JUR-STAFF-013	5.0
JUR-STAFF-041	5.0
JUR-STAFF-027	4.75

6. Metodat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: **4.45**

Megjithatë shumica e profesorëve janë vlerësuar lartë në këtë aspekt, një ose dy raste me nota të ulëta ndikojnë në mesatare. Megjithatë, vlerësimi mbetet në nivel të kënaqshëm.

Tabela 6: Metodatat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-014	4.25
JUR-STAFF-002	2.75
JUR-STAFF-013	5.0
JUR-STAFF-041	4.75
JUR-STAFF-027	4.75

Komente cilësore nga studentët:

- Është theksuar nevoja për vizita studimore më të shpeshta në institucione përtej gjykatave.
- Një koment përmend pakënaqësi ndaj një profesori specifik dhe kërkesë për zëvendësim.
- Ka sugjerime për lidhje më të ngushtë të teorisë me praktikën në kuadër të lëndëve.

Përfundim

Rezultatet e vlerësimit për semestrin e gjashtë reflektojnë një përvojë përgjithësisht pozitive, por me dallime të ndjeshme mes stafit për disa kritere, veçanërisht në qartësi dhe interaktivitet. Studentët kanë vlerësuar lartë rregullsinë dhe materialet e mësimi, ndërsa kanë theksuar nevojën për përmirësime në komunikim dhe angazhim më të madh gjatë orëve. Komentet tregojnë interes për një qasje më praktike dhe bashkëkohore në ligjërata.

VITI IV: SEMESTRI VIII

4.1. Specializimi Civil (Prishtinë)

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë gjithsej 7 studentë, të cilët kanë vlerësuar performancën e 4 mësimeve të Fakultetit Juridik përmes gjashtë kritereve kryesore. Secili kriter është vlerësuar në shkallë nga 1 (shumë dobët) në 5 (shkëlqyeshëm).

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: **4.11**

Tre profesorë kanë marrë vlerësime shumë të larta (deri në 5), ndërsa JUR-STAFF-046 ka pasur vlerësime më të ulëta nga disa studentë.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	2.71
JUR-STAFF-002	4.14
JUR-STAFF-037	4.71
JUR-STAFF-012	5.00

2. Rregullsia në ligjërata

Mesatarja e përgjithshme: 4.39

Të gjithë mësimeve janë vlerësuar mirë, por JUR-STAFF-046 ka disa vlerësime të ulëta që ndikojnë negativisht në mesatare.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	3.29
JUR-STAFF-002	4.71
JUR-STAFF-037	4.86
JUR-STAFF-012	5.00

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: 4.36

Performancë shumë e mirë në përgjithësi, por me perjashtim të JUR-STAFF-046.

Tabela 3: Qartësia në ligjërim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	2.71
JUR-STAFF-002	4.57

JUR-STAFF-037	4.71
JUR-STAFF-012	5.00

4. Interaktiviteti dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: 4.36

Shumica e stafit vlerësohen shumë pozitivisht; JUR-STAFF-046 dallon me notat më të ulëta.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	2.57
JUR-STAFF-002	4.57
JUR-STAFF-037	4.71
JUR-STAFF-012	5.00

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: 4.43

Të gjithë mësimdhënësit kanë pasur qasje të mirë, ndonëse JUR-STAFF-046 ka marrë disa nota më të ulëta.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	3.14
JUR-STAFF-002	4.43
JUR-STAFF-037	4.71
JUR-STAFF-012	5.00

6. Metodat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: 4.43

Shumica e mësimdhënësve kanë marrë nota shumë të larta; përjashtim përbën JUR-STAFF-046.

Tabela 6: Metodat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	3.00
JUR-STAFF-002	4.29
JUR-STAFF-037	4.86
JUR-STAFF-012	4.86

Komente cilësore nga studentët

- Sugjerime për më shumë vizita studimore, përfshirje në konferenca dhe praktika në gjykata.
- Ankesa për penalizime të tepërta në nota.
- Vlerësime shumë pozitive për jur-staff-012 dhe jur-staff-037, të cilat përshkruhen si profesionale, të qarta dhe mbështetëse.

Përfundim

Vlerësimi i stafit akademik për semestrin VIII tregon një performancë të përgjithshme të kënaqshme, me dallime të qarta mes stafit. Pikat e forta përfshijnë:

- Qartësia dhe profesionalizmi i disa mësimeve.
- Angazhimi dhe interaktiviteti të shumica e stafit.

Rekomandimet për përmirësim janë:

- Qartësia dhe interaktiviteti për JUR-STAFF-046.
- Kërkohej më shumë qasje praktike, përmes vizitave jashtë auditorit dhe angazhimit në jetën akademike jashtëkurrikulare.

4.2. Specializimi Penal

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë gjithsej 2 studentë, të cilët kanë vlerësuar performancën e 4 mësimeve të Fakultetit Juridik përmes gjashtë kriterëve kryesore. Secili kriter është vlerësuar në shkallë nga 1 (shumë dobët) në 5 (shkëlqyeshëm).

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: **4.13**

Rezultatet tregojnë një nivel të mirë të qartësisë së obligimeve të studentëve që në fillim të semestrit. Dy anëtarë të stafit janë vlerësuar maksimalisht nga të dy studentët, ndërsa dy të tjerë kanë marrë nota më të ulëta, duke ndikuar në uljen e mesatares së përgjithshme.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	3.0
JUR-STAFF-002	3.5
JUR-STAFF-013	5.0
JUR-STAFF-043	5.0

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja e përgjithshme: **4.38**

Të dhënat tregojnë një nivel të lartë të rregullsisë në mbajtjen e orëve mësimore për shumicën e stafit. Tre nga katër profesorët janë vlerësuar me notën maksimale, duke reflektuar konsistencë dhe përkushtim në orarin mësimor. Ndërkohë, një profesor ka marrë nota dukshëm më të ulëta nga të dy studentët, duke ndikuar në uljen e mesatares totale.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	1.5
JUR-STAFF-002	5.0
JUR-STAFF-013	5.0
JUR-STAFF-043	5.0

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: **4.25**

Të dhënat tregojnë se shumica e stafit janë vlerësuar pozitivisht për qartësinë gjatë ligjëratave dhe sqarimeve në orë. Tre profesorë kanë marrë notën maksimale nga të dy studentët. Megjithatë, një profesor (JUR-STAFF-046) ka marrë nota dukshëm më të ulëta, që e ulin mesataren e përgjithshme për këtë kriter.

Tabela 3: Qartësia në ligjërim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	2.0
JUR-STAFF-002	5.0
JUR-STAFF-013	5.0
JUR-STAFF-043	5.0

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: **4.25**

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	2.0
JUR-STAFF-002	5.0
JUR-STAFF-013	5.0
JUR-STAFF-043	4.5

Tre profesorë janë vlerësuar shumë lartë, ndërsa një profesor ka marrë nota më të ulëta që ndikojnë në uljen e mesatares.

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: **4.5**

Studentët kanë vlerësuar lart qasjen dhe përmbajtjen e materialeve mësimore për shumicën e stafit. Tre mësimdhënës kanë marrë nota maksimale, duke reflektuar përgatitje dhe qasje të mirë në burimet mësimore, ndërsa një anëtar i stafit ka marrë nota më të ulëta.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	2.5
JUR-STAFF-002	5.0
JUR-STAFF-013	5.0
JUR-STAFF-043	5.0

6. Metodat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: **4.38**

Të dhënat tregojnë se shumica e stafit kanë përdorur metoda të përshtatshme të vlerësimit, duke përfshirë edhe vlerësimin e vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit. Tre profesorë janë vlerësuar me notën maksimale, ndërsa një ka marrë vlerësime dukshëm më të ulëta që ndikuar në mesataren e përgjithshme.

Tabela 6: Metodat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-046	1.5
JUR-STAFF-002	5.0
JUR-STAFF-013	5.0
JUR-STAFF-043	5.0

Komente cilësore nga studentët:

Nuk janë dhënë komente apo sugjerime shtesë në këtë pyetësor.

Përfundim i përgjithshëm

- Rezultatet për semestrin e tetë në specializimin Penal reflektojnë një përvojë të përgjithshme pozitive dhe konsistente me përjashtime të vogla. Tre nga katër anëtarët e stafit akademik janë vlerësuar shumë lartë në të gjitha kategoritë, duke dëshmuar përkushtim, qartësi dhe profesionalizëm të lartë në procesin mësimor.

- Një mësimdhënës në veçanti ka marrë vlerësime dukshëm më të ulëta për shumicën e kritereve, që kërkon vlerësim të brendshëm dhe mbështetje për përmirësim në qartësi, rregullsi, bashkëpunim dhe qasje në materialet didaktike.

KAPITULLI II: ANALIZË E REZULTATEVE TË PYETËSORIT TË VLERËSIMIT TË STAFIT-DEGA PRIZREN

VITI 1: SEMESTRI II (Dega Prizren)

Në këtë pyetësor ka marrë pjesë vetëm një student, i cili ka vlerësuar performancën e 6 anëtarëve të stafit akademik. Edhe pse numri i përgjigjeve është minimal dhe jo përfaqësues për të nxjerrë përfundime të përgjithshme statistikore, rezultatet megjithatë ofrojnë një pasqyrë individuale të perceptimit të këtij studenti për secilin staf. Vlerësimet janë dhënë në shkallën nga 1 (shumë dobët) deri në 5 (shkëlqyeshëm) dhe përfshijnë aspekte kyçe të procesit mësimor.

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Studenti e ka vlerësuar qartësinë e syllabusit maksimalisht për të gjithë mësimdhënësit.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Edhe në këtë kriter, të gjithë mësimdhënësit janë vlerësuar maksimalisht, duke reflektuar një përkushtim të lartë në respektimin e orarit dhe vazhdimësinë e ligjëratave.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: 3.0

Ky është kriteri i parë me vlerësime më të ulëta, veçanërisht për disa anëtarë të stafit. Ndërsa disa janë vlerësuar me 5, të tjerët kanë marrë nota 2 dhe 3, çka sugjeron dallime të ndjeshme në mënyrën e ligjërimit dhe shpjegimit.

Tabela 3: Qartësia në ligjërim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	2.0
JUR-STAFF-035	2.0
JUR-STAFF-039	3.0
JUR-STAFF-033	4.0
JUR-STAFF-008	5.0
JUR-STAFF-038	2.0

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: 2.83

Ky është kriteri me vlerësimet më të ulëta në këtë pyetësor. Studentit i është krijuar përshtypja se disa profesorë nuk kanë qenë mjaftueshëm të përfshirë në ndërveprim apo bashkëpunim aktiv me studentët.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	2.0
JUR-STAFF-035	2.0
JUR-STAFF-039	2.0
JUR-STAFF-033	4.0
JUR-STAFF-008	5.0
JUR-STAFF-038	2.0

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: 3.17

Ndërsa për disa profesorë janë dhënë vlerësime maksimale, për të tjerë notat janë shumë të ulëta, duke sugjeruar mungesë konsistence në ofrimin e burimeve didaktike.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	2.0
JUR-STAFF-035	2.0
JUR-STAFF-039	3.0
JUR-STAFF-033	5.0
JUR-STAFF-008	5.0
JUR-STAFF-038	2.0

6. Metodat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: 3.5

Vlerësimet janë më të përziera në këtë kategori. Disa mësimdhënës janë vlerësuar me nota të larta për drejtësinë dhe vazhdimësinë në vlerësim, ndërsa të tjerë me nota më të ulëta. Kjo sugjeron nevojën për harmonizim të standardeve të vlerësimit ndërmjet stafit.

Tabela 6: Metodat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-024	3.0
JUR-STAFF-035	3.0
JUR-STAFF-039	4.0
JUR-STAFF-033	4.0
JUR-STAFF-008	5.0
JUR-STAFF-038	2.0

Komente cilësore nga studentët

- Nuk është dhënë asnjë koment apo sugjerim shtesë në këtë pyetësor.

Përfundim

Rezultatet e pyetësorit për semestrin e dytë në Prizren tregojnë një performancë të lartë në aspektet organizative, si qartësia e syllabusit dhe rregullsia në ligjërata. Megjithatë, ka dallime të theksuara në qartësinë gjatë ligjërimit, interaktivitetin dhe ofrimin e materialeve, që duhet adresuar për të unifikuar përvojën e studentëve.

Përmirësime rekomandohen veçanërisht në:

- Rritjen e interaktivitetit dhe bashkëpunimit në klasë.
- Sigurimin e materialeve cilësore dhe të qasshme për të gjitha lëndët.
- Zbatimin e njëtrajtshëm të metodave të vlerësimit.

Për shkak të numrit të kufizuar të përgjigjeve (vetëm 1 student), këto gjetje duhet të interpretohen me kujdes dhe të konsiderohen si sinjal orientues për përmirësim të mëtejshëm.

VITI I DYTË: SEMESTRI IV (Dega Prizren)

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë gjithsej 3 studentë të vitit të dytë të Fakultetit Juridik, të cilët kanë vlerësuar performancën e 5 anëtarëve të stafit akademik përmes një sërë kriteresh pedagogjike. Vlerësimet janë dhënë në shkallën nga 1 (shumë dobët) deri në 5 (shkëlqyeshëm) dhe kanë përfshirë aspekte kyçe të procesit mësimor. Më poshtë paraqiten vërejtjet dhe analiza kryesore:

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Të gjithë anëtarët e stafit janë vlerësuar me notën maksimale në këtë kategori, çka dëshmon për një standard të lartë të transparencës dhe komunikimit të detyrimeve të lëndëve.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Studentët kanë shprehur kënaqësi të plotë për përkushtimin dhe rregullsinë e profesorëve në ligjëratat. Nuk janë shënuar mungesa, vonesa apo lëshime para kohe.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Të gjitha vlerësimet janë maksimale, duke dëshmuar për aftësi të shkëlqyera të stafit në shpjegim dhe komunikim akademik.

Tabela 3: Qartësia në ligjërim

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Studentët kanë raportuar për nivel shumë të lartë të bashkëpunimit dhe përfshirjes në mësim, duke përkrahur një ambient të hapur e mbështetës për mësim dhe diskutim.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Studentët kanë vlerësuar shumë lartë cilësinë dhe qasjen në materialet didaktike, duke treguar për përgatitje dhe organizim shumë të mirë të lëndëve.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

6. Metodat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Të gjithë mësimdhënësit janë vlerësuar me notë maksimale për përdorimin e metodave të drejta dhe të vazhdueshme të vlerësimit, duke treguar për korrektësi në procesin e vlerësimit akademik.

Tabela 6: Metodat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

Komente cilësore nga studentët

Studentët kanë shprehur kënaqësi të plotë me angazhimin dhe profesionalizmin e stafit akademik. Ata theksojnë cilësinë e lartë të mësimdhënies dhe korrektësinë e mësimdhënësve. Në mënyrë të veçantë, JURSTAFF-031 është vlerësuar për qartësinë në shpjegim, profesionalizmin dhe respektin e treguar ndaj studentëve.

Përfundim

Rezultatet e pyetësorit për semestrin e katërt në Prizren janë jashtëzakonisht pozitive. Studentët kanë vlerësuar me nota maksimale të gjithë anëtarët e stafit në të gjitha kategoritë. Komentet cilësore nënvizojnë cilësinë, përkushtimin dhe respektin që studentët kanë për profesorët, në veçanti për JURSTAFF-031.

Performanca e këtij semestri reflekton një standard të lartë profesional dhe mund të shërbejë si model suksesi në mësimdhënie për programe të tjera.

VITI I TRETË: SEMESTRI VI (Dega Prizren)

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë gjithsej 3 studentë të vitit të tretë të Fakultetit Juridik, të cilët kanë vlerësuar performancën e 5 anëtarëve të stafit akademik përmes një sërë kriteresh pedagogjike. Vlerësimet janë dhënë në shkallën nga 1 (shumë dobët) deri në 5 (shkëlqyeshëm) dhe kanë përfshirë aspekte kyçe të procesit mësimor. Më poshtë paraqiten vërejtjet dhe analiza kryesore:

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: 4.93

Vlerësimet tregojnë një nivel shumë të lartë të qartësisë së detyrimeve në lëndë. Studentët janë përgjithësisht të kënaqur me prezantimin e syllabusit.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-014	5.0
JUR-STAFF-016	4.67
JUR-STAFF-041	5.0
JUR-STAFF-027	5.0
JUR-STAFF-024	4.67

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Të gjithë anëtarët e stafit janë vlerësuar me notën maksimale, duke treguar një përkushtim të lartë në respektimin e orarit dhe mbarëvajtjen e ligjëratave.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: 4.93

Edhe në këtë kriter, shumica e vlerësimeve janë maksimale. Dallimet janë të vogla dhe tregojnë një nivel të lartë të aftësisë për të komunikuar qartë dhe për të shpjeguar përmbajtjen e lëndës.

Tabela 3: Qartësia në ligjërime

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-014	5.0
JUR-STAFF-016	4.67
JUR-STAFF-041	5.0
JUR-STAFF-027	5.0
JUR-STAFF-024	5.0

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Të gjitha vlerësimet janë maksimale, çka dëshmon për një përfshirje aktive të studentëve dhe një klimë të favorshme bashkëpunimi në klasë.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Studentët kanë shprehur vlerësime maksimale për materialet e lëndës, duke reflektuar përgatitje të mirë dhe qasje të lehtë në burimet përkatëse.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

6. Metodat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Kriteri është vlerësuar maksimalisht nga të gjithë studentët, çka tregon për korrektësi dhe konsistencë në zbatimin e vlerësimit të vazhdueshëm.

Tabela 6: Metodat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
Të gjithë	5.0

Komente cilësore nga studentët

Komentet e studentëve janë përgjithësisht pozitive. Dy studentë nuk kanë shprehur ndonjë koment apo sugjerim shtesë, ndërsa njëri ka theksuar nevojën për më shumë qartësi dhe kontroll në përmbajtjen e materialeve mësimore, duke e paraqitur si një kritikë konstruktive për përmirësim të vazhdueshëm.

Përfundim

Rezultatet e pyetësorit për semestrin e gjashtë në Prizren janë shumë pozitive, me vlerësime maksimale në shumicën e kategorive. Studentët kanë treguar kënaqësi të lartë për organizimin, bashkëpunimin dhe vlerësimin nga ana e stafit akademik. Një koment i vetëm kritikon lehtësisht aspektin e qartësisë së materialeve-sugjerim i vlefshëm për përmirësim.

VIII-SPECIALIZIMI PENAL (VITI I KATËRT, DEGA PRIZREN)

Në këtë pyetësor ka marrë pjesë vetëm një student, i cili ka vlerësuar performancën e 4 anëtarëve të stafit akademik në specializimin Penal. Edhe pse numri i përgjigjeve është minimal dhe jo përfaqësues për të nxjerrë përfundime të përgjithshme statistikore, rezultatet megjithatë ofrojnë një pasqyrë individuale të perceptimit të këtij studenti për secilin staf.

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: 4.5

Studenti ka vlerësuar tre nga katër mësimdhënësit me notën maksimale për qartësinë e syllabusit, me një përjashtim (nota 3), që ka ndikuar në uljen e lehtë të mesatares.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Vlerësimi
JUR-STAFF-016	5
JUR-STAFF-042	3
JUR-STAFF-026	5
JUR-STAFF-043	5

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja e përgjithshme: 4.5

Vlerësimi është përgjithësisht i mirë, me dy nota 4 dhe dy nota 5.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Vlerësimi
JUR-STAFF-016	4
JUR-STAFF-042	4
JUR-STAFF-026	5
JUR-STAFF-043	5

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: 4.0

Të gjithë mësimdhënësit janë vlerësuar në mënyrë të njëtrajtshme me notën 4 për këtë kategori.

Tabela 3: Qartësia në ligjërime

Kodi i stafit	Vlerësimi
JUR-STAFF-016	4
JUR-STAFF-042	4
JUR-STAFF-026	4
JUR-STAFF-043	4

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: 4.0

Vlerësimet janë të njëjta për të gjithë stafin – nota 4, çka tregon për një nivel të mirë të përfshirjes, por me hapësirë për përmirësim.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Vlerësimi
JUR-STAFF-016	4
JUR-STAFF-042	4
JUR-STAFF-026	4
JUR-STAFF-043	4

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: 3.0

Ky është kriteri më i ulët i vlerësuar në këtë pyetësor. Dy nga profesorët janë vlerësuar me notën 3, një me 2 dhe vetëm një me 4, gjë që tregon për nevojën e përmirësimit në përgatitjen dhe qasjen në materialet mësimore.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Vlerësimi
JUR-STAFF-016	3
JUR-STAFF-042	2
JUR-STAFF-026	3
JUR-STAFF-043	4

6. Metodat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: 3.25

Edhe kjo kategori është vlerësuar në mënyrë mesatare, me nota që variojnë nga 3 deri në 4, çka sugjeron nevojën për më shumë përkushtim në mënyrën e vlerësimit të studentëve gjatë semestrit.

Tabela 6: Metodatat e vlerësimit

Kodi i stafit	Vlerësimi
JUR-STAFF-016	3
JUR-STAFF-042	3
JUR-STAFF-026	3
JUR-STAFF-043	4

Komente cilësore nga studenti:

- Nuk është dhënë asnjë koment apo sugjerim shtesë në këtë pyetësor.

Përfundim

Duke marrë parasysh që pyetësori është plotësuar vetëm nga një student, rezultatet nuk mund të konsiderohen përfaqësuese për grupin e studentëve të specializimit Penal. Megjithatë, ato japin sinjale të dobishme:

- Performanca e stafit në aspektet themelore të mësimdhënies (qartësia, rregullsia, interaktiviteti) është vlerësuar si pozitive.
- Ka vend për përmirësim në qasjen ndaj materialeve mësimore dhe metodologjinë e vlerësimit.
- Rekomandohet që në të ardhmen të sigurohet një pjesëmarrje më e gjerë për të gjeneruar një pasqyrë më të besueshme.

KAITPULLI 3: PROGRAMET MASTER

3.1. E Drejta Civile dhe e Pronës (LLM)-Semestri II (Prishtinë)

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë gjithsej 5 studentë të nivelit Master në programin E Drejta Civile dhe e Pronës. Studentët kanë vlerësuar 5 anëtarë të stafit akademik përmes 6 kritereve kryesore të cilat përfshijnë qartësinë e obligimeve, rregullsinë në mësim, interaktivitetin dhe përdorimin e metodave të vlerësimit. Vlerësimet janë dhënë në shkallën 1 (shumë dobët) deri 5 (shkëlqyeshëm). Më poshtë paraqiten vërejtjet dhe analiza për secilin kriter:

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: 4.36

Pjesa më e madhe e stafit është vlerësuar pozitivisht për qartësinë e syllabusit dhe detyrimeve të parashtruara në fillim të semestrit. Megjithatë, për dy stafë janë dhënë nota me të ulëta që ndikojnë në mesataren përkatese.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-012	4.2
JUR-STAFF-027	5.0
JUR-STAFF-037	5.0
JUR-STAFF-021	4.4
JUR-STAFF-007	3.2

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja e përgjithshme: 4.52

Stafi është vlerësuar mirë për rregullsinë, me përjashtim të dy rasteve që kanë marrë notën pak me te ulet. Ky element sugjeron përgjithësisht respektim të orarit dhe obligimeve mësimore.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-012	4.2
JUR-STAFF-027	4.4
JUR-STAFF-037	5.0
JUR-STAFF-021	4.8
JUR-STAFF-007	4.2

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: 4.48

Stafi në përgjithësi ka marrë nota të larta për mënyrën e komunikimit dhe sqarimit të përmbajtjes ligjërimore, me përjashtim të një stafi që është vlerësuar me notën 1 nga dy studentë.

Tabela 3: Qartësia në ligjërime

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-012	4.8
JUR-STAFF-027	4.8
JUR-STAFF-037	4.8
JUR-STAFF-021	4.4
JUR-STAFF-007	3.2

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: 4.4

Studentët e kanë vlerësuar stafin si të përkushtuar dhe të gatshëm për bashkëpunim, me vlerësime të qëndrueshme në tërësi. Edhe këtu ka një notë të ulët për një staf që ka ndikuar në uljen e mesatares.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-012	4.6
JUR-STAFF-027	4.8
JUR-STAFF-037	5.0
JUR-STAFF-021	4.6
JUR-STAFF-007	3.2

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: 4.4

Materialet janë vlerësuar si të dobishme dhe të qasshme nga shumica e studentëve, përveç një rasti ku është dhënë nota minimale. Në përgjithësi, ky element është trajtuar mirë nga stafi.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-012	4.4
JUR-STAFF-027	4.6
JUR-STAFF-037	4.6
JUR-STAFF-021	4.6
JUR-STAFF-007	4.0

6. Metodat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: 4.56

Ky kriter është vlerësuar lartë, çka tregon se metodat e vlerësimit janë konsideruar të drejta dhe të qarta. Një staf ka marrë notën 1 nga një student, që ka ulur pak mesataren.

Tabela 6: Metodat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-012	4.4
JUR-STAFF-027	5.0
JUR-STAFF-037	5.0
JUR-STAFF-021	4.6
JUR-STAFF-007	3.8

Komente cilësore nga studentët:

- Tre studentë nuk kanë dhënë komente ose kanë shënuar simbole pa përmbajtje.
- Një student ka veçuar me emër jur-staff-012 dhe jur-staff-027 për mësimdhënie të shkëlqyer.
- Një student ka paraqitur ankesë për paqartësi në orar dhe ndryshime të papritura, duke sugjeruar më shumë korrektësi në planifikimin e kontratave dhe respektimin e kushteve të paracaktuara.

Përfundim

Rezultatet e vlerësimit për këtë grup të studentëve të programit LLM janë shumë të mira, veçanërisht në kriteret që lidhen me përgatitjen akademike dhe cilësinë e mësimdhënies. Ka disa vlerësime kritike për një pjesë të stafit, por në përgjithësi studentët kanë vlerësuar angazhimin, profesionalizmin dhe transparencën në procesin mësimor. Komentet për korrektësinë administrative (si orari) duhet të merren parasysh për përmirësime të mëtejshme.

3.2. E Drejta Penale (LLM)-Semestri II (Prishtinë)

Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë gjithsej 6 studentë të nivelit Master, të cilët kanë vlerësuar 2 mësimdhënës përmes 6 kriterëve pedagogjike që lidhen me cilësinë e ligjëratave, bashkëpunimin me studentët, metodat e vlerësimit dhe qartësinë e syllabusit. Vlerësimet janë dhënë në shkallën nga 1 (shumë dobët) deri 5 (shkëlqyeshëm). Rezultatet janë shumë pozitive dhe dëshmojnë për një angazhim të lartë të stafit. Më poshtë paraqiten mesataret dhe komentet.

1. Qartësia e obligimeve sipas syllabusit

Mesatarja e përgjithshme: 4.75

Studentët kanë vlerësuar shumë lart mënyrën se si janë prezantuar detyrimet dhe struktura e lëndëve në fillim të semestrit. Profesori me kodin **JUR-STAFF-002** ka marrë nota maksimale nga të gjithë, ndërsa **JUR-STAFF-013** ka një mesatare të lartë por me një notë pak më të ulët.

Tabela 1: Qartësia e obligimeve

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-002	5.00
JUR-STAFF-013	4.50

2. Rregullsia në mbajtjen e ligjëratave

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Të dy profesorët janë vlerësuar me nota maksimale nga të gjithë studentët, çka tregon për rregullsi dhe respektim të plotë të orarit dhe obligimeve akademike.

Tabela 2: Rregullsia në mësim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-002	5.00
JUR-STAFF-013	5.00

3. Qartësia gjatë ligjërimit

Mesatarja e përgjithshme: 5.00

Studentët kanë vlerësuar mënyrën e ligjërimit si shumë të qartë dhe të strukturuar, pa pasur ndonjë kritikë. Të dy profesorët kanë marrë vlerësimin maksimal.

Tabela 3: Qartësia në ligjërim

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-002	5.00
JUR-STAFF-013	5.00

4. Nxitja e interaktivitetit dhe bashkëpunimi me studentët

Mesatarja e përgjithshme: 4.92

Studentët kanë përjetuar një ambient të hapur dhe bashkëpunues. Vetëm një student ka dhënë notën 4 për JUR-STAFF-013, ndërsa të tjerët kanë dhënë nota 5 për të dy.

Tabela 4: Interaktiviteti

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-002	5.00
JUR-STAFF-013	4.83

5. Përshtatshmëria dhe qasja në materialet mësimore

Mesatarja e përgjithshme: 4.83

Studentët kanë raportuar se materialet e lëndës ishin të qasshme dhe të mjaftueshme, megjithëse një vlerësim me notën 3 për të dy profesorët ka ndikuar në uljen e lehtë të mesatares.

Tabela 5: Materialet e lëndës

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-002	4.83
JUR-STAFF-013	4.83

6. Metodatat e vlerësimit dhe përdorimi i vlerësimit të vazhdueshëm

Mesatarja e përgjithshme: 4.83

Edhe për këtë kriter, të dy profesorët janë vlerësuar shumë pozitivisht. Studentët e kanë perceptuar vlerësimin si të drejtë dhe të mirëorganizuar përgjatë gjithë semestrit.

Tabela 6: Metodat e vlerësimit

Kodi i stafit	Mesatarja
JUR-STAFF-002	4.83
JUR-STAFF-013	4.83

Komente cilësore nga studentët:

- Një studente ka vlerësuar profesorët për metodat e qarta, përkushtimin dhe qasjen bashkëkohore, duke theksuar ndikimin pozitiv që kanë pasur në formimin e saj profesional.
- Profesori me kodin 013 është vlerësuar për gatishmërinë dhe kujdesin ndaj studentëve, ndërsa 012 për frymëzim, afërsi dhe profesionalizëm.
- Të tjerët kanë shënuar: “*Nuk kam*”, “*Nuk ka*”, “.”, që sugjeron kënaqësi të heshtur dhe mungesë ankesash.

Përfundim

Rezultatet e pyetësorit për programin LLM në të Drejtën Penale janë jashtëzakonisht pozitive dhe konsistente. Studentët kanë vlerësuar në mënyrë të njëzëshme kualitetin e lartë të mësimdhënies, qartësinë, rregullsinë dhe përkrahjen nga stafi akademik. Komentet cilësore theksojnë jo vetëm kompetencën akademike por edhe rolin njerëzor dhe motivues të profesorëve në përgatitjen profesionale të studentëve të nivelit master.

KONKLUZIONET

Nga Raporti i Cilësisë për Semestrin Veror 2024-2025 për Fakultetin Juridik, mund të nxjerrim konkluzionet e mëposhtme të përgjithshme:

1. Cilësia e përgjithshme e mësimdhënies është e qëndrueshme dhe pozitive, me shumicën e kriterëve që tejkalojnë pragun 4.0 të përcaktuar në Planin Strategjik të Fakultetit.
2. Rregullsia në ligjërata dhe qasja në materialet mësimore janë vlerësuar më së larti nga studentët në të gjitha nivelet e studimit.
3. Ekzistojnë dallime të ndjeshme ndërmjet anëtarëve të stafit akademik, sidomos në elementët si: qartësia e ligjërimit, interaktiviteti me studentët dhe metodat e vlerësimit. Disa raste të përsëritura me vlerësime të ulëta kërkojnë trajtim të veçantë.
4. Numri i përgjigjeve të studentëve në disa semestra është shumë i ulët, çka ndikon në besueshmërinë statistikore të vlerësimeve – sidomos në degën Prizren dhe në disa grupe të programeve master.
5. Programet master, veçanërisht LLM në të Drejtën Penale, tregojnë një performancë shumë të lartë dhe janë shembull pozitiv në aspektin e përkushtimit, qartësisë dhe profesionalizmit të stafit.
6. Studentët kanë theksuar nevojën për më shumë interaktivitet, vizita studimore dhe lidhje më të ngushtë të teorisë me praktikën – veçanërisht në vitet e avancuara të studimeve.
7. Raporti rekomandon rritjen e transparencës në obligime, përdorimin e metodave aktive të mësimdhënies dhe përmirësimin e qasjes në materiale, duke promovuar gjithashtu kulturën e vlerësimit të cilësisë nga vetë studentët.

Rekomandimet për përmirësim

Raporti përfundon me disa rekomandime thelbësore:

1. Rritje të interaktivitetit dhe përdorimin e metodave aktive në ligjërata;
2. Sigurimi i qartësisë në syllabus dhe materialet e lëndës;
3. Ndërgjegjësim me i madh i studentëve për rëndësinë e vlerësimit të cilësisë.

ANEKSI

Forma e pyetësorit

1. A kanë qenë të qarta detyrimet tuaja si student për lëndën që nga fillimi, sipas sylabusit të postuar?
1
2
3
4
5
 2. A është mësimdhënësi i rregullt (nuk ka vonesa ose nuk e perfundon orën më herët)?
1
2
3
4
5
 3. A është mësimdhënësi i qartë gjatë ligjëratave dhe shpjegimeve në klasë?
1
2
3
4
5
 4. A nxit mësimdhënësi interaktivitet gjatë ligjëratave/ushtimeve dhe bashkëpunim me studentët?
1
2
3
4
5
 5. A ishin materialet e lëndës të përshtatshme për studim dhe a ishin të qasshme në UBT?
1
2
3
4
5
 6. A përdor mësimdhënësi metoda të përshtatshme të vlerësimit dhe a aplikon vlerësimin e vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit?
1
2
3
4
5
 7. Komente ose sugjerime shtesë:
-

